



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS  
DHOMAT E SHKALLËS SË DYTË

---

Numri i lëndës: 2019:268781  
Datë: 12.11.2024  
Numri i dokumentit: 06440451

K.Dh.Sh.II.nr.222/22

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS - Dhomat e Shkallës së Dytë, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët Dren Rogova, kryetar, Krenar Berisha dhe Ramush Bardiqi, anëtarë, në konfliktin administrativ sipas padisë së paditësit “Raiffaisen Bank Kosovo” JSC, me seli në Prishtinë, kundër të paditurës Administrata Tatimore e Kosovës në Prishtinë, me bazë juridike, anulim vendimi, duke vendosur lidhur me ankesën e paditësit, ushtruar kundër Aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë- Departamenti për Çështje Administrative, Divizioni Fiskal, A.nr.1355/17 të datës 06.10.2020, në seancën e kolegjit të mbajtur me datë 12.11.2024, merr këtë:

A K T G J Y K I M

Refuzohet si e pa bazuar ankesa e paditësit “Raiffaisen Bank Kosovo” JSC, me seli në Prishtinë, ndërsa aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë - Departamenti për Çështje Administrative - Divizioni Fiskal, A.nr.1355/17, i datës 06.10.2020, vërtetohet.

A r s y e t i m

Me aktgjykimin e Gjykatës Themelore në Prishtinë - Departamenti për Çështje Administrative - Divizioni Fiskal, A.nr.1355/17, të datës 06.10.2020, është refuzuar si e pabazuar kërkesëpadia e paditësit dhe ka mbetur në fuqi vendimi nr.184/2017 i datës 12.07.2017 i Administratës Tatimore të Kosovës në Prishtinë.

Kundër këtij aktgjykimi në afatin ligjor ka ushtruar ankesë paditësi, për shkak të: konstatimit të gabuar të gjendjes faktike dhe zbatimit të gabuar të së drejtës materiale me propozimin që të aprovohet në tërësi ankesa e paditësit si e bazuar, të prishet aktgjykimi i apeluar i Gjykatës Themelore në Prishtinë A.nr.1355/17, duke e kthyer në rigjykim në gjykatën e shkallës së parë, ose të ndryshohet aktgjykimi i apeluar duke vendosur në mënyrë meritore në konfliktin administrativ në dobi të paditësit, dhe njëkohësisht duke e aprovuar kërkesëpadinë e palës paditëse.

Gjykata Komerciale- Dhoma e Shkallës së Dytë, shqyrtoi shkresat e lëndës, aktgjykimin e ankimuar, pretendimet ankimore dhe pas vlerësimit të tyre në kuptim të nenit 49 të LKA-së,

nenit 81.H të Ligjit për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit për Administratën Tatimore dhe Procedurat nr.03/L-222, lidhur me nenin 194 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK), të aplikueshëm sipas nenit 63 të Ligjit për Konfliktet Administrative (LKA), gjeti se:

Ankesa është e pa bazuar.

Nga shkresat e lëndës rezulton se e paditura Administrata Tatimore e Kosovës, me vendimin nr.184/2017, të datës 12.07.2017, ka refuzuar ankesën nr.184/2017 të datës 19.05.2017 e tatimpaguesit “Raiffesisen Bank Kosovo” J.S.C me NRB: 70025959, NRF: 600124317, me drejtor Ferenc Berszan, me seli të biznesit në Rr. UÇK-së nr.51 – Prishtinë, në mbështetje të nenit 132/2 të Ligjit nr.05/L-031 “Për Procedurën e Përgjithshme Administrative” në lidhje me paragrafin 2 të nenit 89 të Ligjit nr.03/L-222 ‘Për Administratën Tatimore dhe Procedurat’, dhe ka vërtetuar si të bazuar Njoftim – rivlerësimin e datës 18.04.2017.

Paditësi i pa kënaqur me vendimin e lartcekur të paditurës Administrata Tatimore e Kosovës, ka ushtruar padi për konflikt administrativ me datën 14.08.2017, me pretendim se i njëjti është i padrejtë dhe i paligjshëm.

Gjykata e shkallës së parë, pas shqyrtimit të padisë së paditësit paraqitur kundër vendimit nr.184/2017, të datës 12.07.2017, të Administratës Tatimore të Kosovës në Prishtinë, dhe pas administrimit të provave si në procesverbal të shqyrtimit kryesor, e duke u bazuar edhe në provat dhe dëshmitë e tjera të lëndës, bie aktgjykimin e ankimuar me të cilën kërkesëpadinë e paditësit e refuzon si të pa bazuar. Gjykata e shkallës së parë në arsyetimin e aktgjykimit të kontestuar ka theksuar se nga provat e administruara, gjykata konstaton se pa mëdyshje vërtetohet fakti se paditësi në rastin konkret nuk e ka zbatuar njoftimin për barrë dhe masë për marrje pasurie-urdhrit për transfer të datës 24.11.2016, sipas kërkesës së ATK-së, përmes të cilit e paditura kishte kërkuar nga bankat të cilat operojnë në Kosovë, përfshirë këtu edhe paditësin që pasurinë/mjetet financiare të subjektit NT “Viva Pharmacie” me seli në Viti, dhe të pronarit të biznesit A.H., të deponuara në llogari bankare, të bllokohen dhe të njëjtat ti transferohen dhe dorëzohen ATK-së, në shumë prej 72,913.05€, për shkak se ky subjekt kishte detyrime tatimore të pa paguara ndaj ATK-së për llojet e tatimit TVSH, TAP-PD, TB dhe KP, për periudhën 2009-2016. Gjykata vlerëson nuk është i bazuar pretendimi i paditësit se paditura njoftim vlerësimin e datës 18.04.2017 dhe vendimin e kontestuar e ka nxjerr në kundërshtim me dispozitat ligjore dhe aplikim të gabuar të ligjit material, sepse sipas gjykatës e paditura me të drejtë dhe në zbatim të nenit 35 të Ligjit nr.03/L-222 për Administratën Tatimore dhe Procedurat, pasi që ka marr njoftimin nga paditësi të datës 02.12.2016, sipas të cilit personi fizik A.H., pronari i biznesit NT “Viva Pharmacie” për shkak të një gabimi teknik të sistemit ka arritur që përmes “E Banking,” të realizoj bartjen e mjeteve në shumë prej 99,500.00€, në llogari të bashkëshortes në “TEB Bankë”, me datë 05.12.2016, përmes njoftimit për barrë dhe masa për marrje pasuri/urdhri për transfer ka kërkuar që borxhin tatimor të biznesit NT “Viva Pharmacie” në shumë prej 72,913.05€, ta paguan paditësi. Pretendimi i paditësit se e paditura ka disponuar me të drejtën ligjore për bllokim të mjeteve të cilat gjendeshin në llogarinë e bashkëshortes së tatimpaguesit, mirëpo nuk ka ndërmarr asnjë veprim në këtë drejtim por e ka ngarkuar paditësin me pagesën e shumës prej 72,913.05€, është i pa bazuar dhe në kundërshtim me gjendjen faktike, me provat

në shkresat e lëndës dhe dispozitat ligjore në fuqi. Për gjykatën nuk është i bazuar as pretendimi tjetër i paditësit sipas të cilit paditësi nuk ka refuzuar apo kundërshtuar të mbaj pasurinë, sepse sipas vlerësimit të kësaj gjykate paditësi në momentin kur njoftimin për barrë dhe masë për marrje pasurie/urdhër transfer të ATK-së të datës 24.11.2016, nuk e ka zbatuar sipas kërkesës së ATK-së, ashtu që kjo masë të përfshijë edhe llogarinë private të pronarit të subjektit NT “Viva Pharmacie” dhe të zgjasë nga dita kur është ushtruar kërkesa për masë për marrjen e pasurisë, e deri në datën kur tatimi i tatimpaguesit në këtë rast subjektit NT “Viva Pharmacie” ti inkasohet borxhi tatimor. Në kontekst të këtij argumenti, gjykata vlerëson se e paditura me veprimin e saj ja ka pa mundësuar të paditurës inkasimin e borxhit tatimor për subjektin NT “Viva Pharmacie”, ngase nuk e ka bërë bllokimin e llogarisë bankare private të pronarit të biznesit siç është kërkuar, prandaj nga e paditura më të drejtë është vlerësuar si mosdorëzim i pasurisë e cila i është nënshtruar masës së marrjes sipas ligjit. Në nenin 34 par 1 dhe 2 të Ligjit nr.03/L-222 për Administratën Tatimore dhe Procedurat është paraparë që *”Në qoftë se një person i cili është i detyruar të paguajë një lloj tatimi nuk paguan ose refuzon të paguajë brenda dhjetë (10) ditëve pas dorëzimit të një njoftimi për vlerësim, Drejtori i Përgjithshëm ose zyrtari i autorizuar me shkrim nga Drejtori i Përgjithshëm ka të drejtë të ligjshme të mbledhë shumën e tillë (dhe shuma të tjera që janë të mjaftueshme për të mbuluar shpenzimet e masës për marrje pasurie) me masën për konfiskimit pasurie që i përket personit të tillë (qoftë në pronësi fizike të tatimpaguesit ose një personi të tretë). 2. Me qëllim që të ekzekutimit të masës për konfiskim pasurie, një zyrtar i autorizuar do t’i dorëzojë njoftimin për konfiskim personit (përfshirë, por jo e kufizuar për, punëdhënësit, bankave, institucioneve të tjera financiare apo autoriteteve publike) që ka kontroll ose posedim të pasurisë që i përket tatimpaguesit (qoftë e tundshme, patundshme, e prekshme ose e paprekshme) ose ai i cili i ka një detyrim tatimpaguesit në kohën kur është nxjerrë masa për marrje pasurie. Një masë për marrje pasurie e ushtruar sipas autoritetit të këtij nënparagrafi do të konsiderohet të jetë një masë për marrje pasurie e vazhdueshme, në kohën kur është ushtruar (shërbyer), që është e shoqëruar me një kopje nga barra tatimore e regjistruar në Regjistrin e Pengut, apo e një regjistri të tillë që mund të jetë pasuese e Regjistrit të Pengut, dhe marrësi i masës së marrjes së pasurisë këshillohet me shkrim që masa për marrje pasurie do të konsiderohet të jetë një masë e vazhdueshme e marrjes së pasurisë që zgjatet nga data kur është ushtruar për së pari herë masa e marrjes së pasurisë deri në datën në të cilën tatimi dhe të gjitha shtesat dhe aktualitetet (përlllogaritjet), paguhen plotësisht, ose masa për marrje pasurie është lëshuar, cilado që është më herët”*. Ndërsa në nenin 35 zbatimi me përmbarim i masës së marrjes të Ligjit nr.03/L-222, është parashikuar se *”1. Çdo person në posedim të (ose që ka detyrim në lidhje me) pasurisë që i nënshtrohet masës së marrjes dhe mbi të cilën është vendosur masa e marrjes, me kërkesë të një zyrtari të autorizuar, do t’ia dorëzojë pasurinë e tillë zyrtarit të autorizuar (ose do të shkarkojë një detyrim i tillë), përveç asaj pjese të pasurisë e cila në kohën e bërjes së kërkesë, i nënshtrohet ekzekutimit sipas një procesi gjyqësor. 2. Çdo person i cili kundërshton ose refuzon të dorëzojë pasurinë që i nënshtrohet masës së marrjes kundrejt kërkesës së zyrtarit të caktuar, mban përgjegjësi personale në formën e një detyrimi ndaj qeverisë në shumën e barabartë me vlerën e pasurisë që nuk është dorëzuar, por nuk tejkalon shumën e tatimit për të cilën është vendosur masa e marrjes (së bashku me interesin, sanksionet dhe shpenzimet), sikur të ishte nën-deklarim i tatimeve. Vendosja e këtij sanksioni nuk e liron personin për të cilin është ushtruar masa e marrjes për detyrimet e tyre për të dorëzuar pronën që do t’i nënshtrohet masës së marrjes së pasurisë që është ushtruar tek ai person në përputhje*

me paragrafin 1 të këtij neni. 3. Përveç detyrimit personal të vënë me paragrafin 5. këtij neni, nëse mosdorëzimi ose refuzimi për të dorëzuar bëhet pa shkak të arsyeshëm, personi në fjalë do t'i nënshtrohet një sanksioni sipas paragrafit 1. të nenit 55 të këtij ligji”. Në nenin 55 par.1 të Ligjit të njëjtë është paraparë se “ Çdo person që nuk e dorëzon apo refuzon të dorëzon pasurinë që i nënshtrohet Konfiskimit së marrjes sipas paragrafit 3. të nenit 35 të këtij ligji do t'i nënshtrohet një ndëshkimi administrativ që është i barabartë me pesëdhjetë përqind (50%) të shumës së zbuluar sipas paragrafit 2. të nenit 35 të këtij ligji”. Prandaj në kuptim të drejtë këtyre dispozitave ligjore, gjykata vlerëson se e paditura ka vepruar drejtë, kur shkak të mos zbatimit të njoftimit për barrë dhe masë për marrje pasurie/urdhër për transfer të datës 24.11.2016, kishte kërkuar nga paditësi fillimisht me datë 05.12.2016, të paguante detyrimet tatimore të subjektit NT “Viva Pharmacie” në shumë prej 72,913.05€, ndërsa po me datë 24.02.2017 me anë të kërkesës së fundit për pagesë sërish kishte kërkuar nga paditësi pagesën e kësaj shumë. Duke qenë se paditësi nuk kishte vepruar sipas kësaj kërkesë, e paditura me datë 07.03.2017 i kishte dorëzuar paditësit njoftimin mbi raport të vlerësimit dhe njoftim vlerësimin, me të cilin bazuar në nenin 35 par.1 dhe 2 të Ligjit nr.03/L-222 kërkonte pagesën e shumës tani prej 66,721.88€, për shkak se një pjesë e shumës së mëparshme ishte paguar nga mjetet financiare të cilat gjendeshin në llogarite bankare të biznesit të NT “Viva Pharmacie”, e të cilat ishin bllokuar nga paditësi. Pasi që paditësi nuk kishte vepruar as pas kësaj kërkesë, e paditura me datë 18.04.2017 ka nxjerr njoftimin mbi raport vlerësimin dhe njoftim vlerësimin me të cilin kërkonte që e paditësi të paguante shumën e përgjithshme prej 100,082.82€, nga kjo shumë prej 66,721.88€ në emër të tatimit dhe shumën prej 33,360.94€, në emër të ndëshkimit administrativ prej 50% të aplikuar për shumën 66,721.88€, pagesën e të cilës e paditura ka refuzuar ta bëjë. Gjykata përfundimisht thekson se ka qenë obligim ligjor i paditësit që njoftimin për barrë dhe masë për marrje pasurie/urdhër për transfer, në lidhje me subjektin NT “Viva Pharmacie” dhe pronarin e saj A.H., të zbatoj sipas kërkesës së ATK-së, dhe se dështimi në përmbushjen e kësaj kërkesë nga ana e paditësit, pa marr parasysh shkakun e tij i cili ka mundur të jetë gabim njerëzor, nuk e ka liruar paditësin nga përgjegjësia ligjore për pagesën e detyrimeve tatimore në shumën e kërkuar për tu dorëzuar nga ATK, duke përfshirë edhe ndëshkimin administrativ prej 50%, i cili është aplikuar më vonë nga e paditura, për shkak se paditësi nuk e kishte vepruar as pas kërkesës së fundit për pagesë të ATK-së të datës 24.02.2017.

Qëndrimin juridik të gjykatës së shkallës së parë, si të rregullt dhe të bazuar në ligj në tërësi e pranon edhe kjo gjykatë, për arsye se aktgjykimi i ankimuar nuk është përfshirë me shkelje qenësore të dispozitave të Ligjit për Konfliktet Administrative, të cilat shkelje gjykata e shkallës së dytë i heton sipas detyrës zyrtare në bazë të nenit 194 të Ligjit për Procedurën Kontestimore, të aplikueshëm sipas nenit 63 të Ligjit për Konfliktet Administrative. Gjykata e shkallës së parë duke vlerësuar ligjshmërinë e aktvendimit të kontestuar në kuptim të nenit 44 par.1 të Ligjit për Konfliktet Administrative, dhe nenit 81G të Ligjit Nr.04/L-102 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit Nr.03/L-222 për Administratën Tatimore dhe Procedurat, në drejtim të thënieve në padi, në përgjigje në padi, provave të administruara në seancë gjyqësore si dhe pas shqyrtimit të shkresave të tjera të lëndës me të drejtë ka konstatuar se kërkesëpadija e paditësit është e pa bazuar.

Sa i përket pretendimeve ankimore të paditësit për vërtetim të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike për faktin se gjykata e shkallës së parë nuk ka vlerësuar drejtë ankesën e paditësit, se tatimpaguesi nuk ka pranuar asnjë njoftim apo kërkesë paraprake. Kolegji vlerëson se nga shkresat e lëndës vërtetohet se e paditura i ka drejtuar tek paditësja shkresën e datës 18.04.2024 njoftim – vlerësim lidhur me mosplotësimin e kërkesës së njoftimit për marrje të apsurisë. Andaj, në rrethanat e rastit konkret, edhe sikundër një shkresë e tillë të mos pranohej nga paditësja, kjo nuk do të ndryshonte gjendjen faktike sa i përket anulimit të vendimit kontestues me padi.

Pretendimet e paditëses se e paditura ka apsur mundësi të shmang borxhin tatimor të subjektit A.H., janë aspekte të cilat gjykata nuk mund t'i trajtojë në këtë procedurë, në të cilën gjykata ka apsur për detyrë vetëm të shqyrtojë ligjshmërinë e aktit administrativ. Në këtë drejtim, Kolegji vie në ëprfundim se akti kontestues me të cilin paditëses i është refuzuar ankesa, lidhur me njoftim – rivlerësimin e dt.18.04.2017 është i ligjshëm pasi që gjykata e shkallës së parë drejtë ka ardhur deri te konstatimi se paditësi nuk kishte vepruar sipas kërkesës së ATK, me c'rast e paditura me datë 07.03.2017 i kishte dorëzuar paditësit njoftimin mbi raport të vlerësimit dhe njoftim vlerësimin, me të cilin bazuar në nenin 35 par.1 dhe 2 të Ligjit nr.03/L-222 kërkonte pagesën e shumë tani prej 66,721.88€.

Gjykata duke i shqyrtuar pretendimet ankimore vlerëson se paditësja konstaton me ankesë se ATK nuk ndërmerr asnjë veprim për ta inkasuar borxhin tatimor nga tatimpaguesi i vërtetë. Këto pretendime, kjo Gjykatë nuk mund t'i merr në shqyrtim pasi që sic u theksuar në këtë procedurë sipas ankesës gjykata ka tagër të vlerësojë vetëm pretendimet ndaj ligjshmërisë së aktgjykimit me të cilin është trajtuar çështja e konfliktit ndaj aktit administrativ. Kjo Gjykatë vlerëson se gjykata e shkallës së parë drejtë ka konstatuar se ka qenë obligim ligjor i paditësit që njoftimin për barrë dhe masë për marrje pasurie/urdhrit për transfer, në lidhje me subjektin NT “Viva Pharmacie” dhe pronarin e saj A.H., të zbatoj sipas kërkesës së ATK-së.

Kolegji i kësaj gjykate duke i shqyrtuar pretendimet ankimore të paditëses vie te konstatimi se pa mëdyshje është vëretuar se e paditura si bankë komerciale, me lëshimet e saj ka ardhur deri tek gjendja epamundësisë së të apditurës në përmbushjen e kësaj kërkesë tatimore dhe mosveprimi, respektivisht lëshimi i paditëses nuk mund të shqyrtohet duke i vlerësuar lëshimet eventuale apo pamundësitë e veprimit nga e paditura, por paditësja përgjigjet për detyrimet ligjore sic përcaktohet me Nenin 34 par 1 dhe 2 të Ligjit për ATK.

Më tej, Kolegji vërteton se gjykata e shkallës së parë drejtë ka vërtetuar faktin se paditësi ka lëshuar ta zbatojë me saktësi njoftimin për barrë dhe masë për marrje pasurie-urdhrit për transfer të datës 24.11.2016, sipas kërkesës së ATK-së. Pretendimet ankimore të paditëses se në rastin konkret nuk kemi të bëjmë me kundërshtim apo refuzim nuk janë pretendime që mund të trajtohen si të bazuara, pasi që një gjë e tillë do të lejonte mundësinë e lëshimeve apo shmangieve të cilat do të ndikonin në mos përmbushje të detyrimeve ligjore.

Kolegji konstaton se nuk janë të bazuara pretendimet ankimore se paditura njoftim vlerësimin e datës 18.04.2017 dhe vendimin e kontestuar e ka nxjerr në kundërshtim me dispozitat ligjore dhe aplikim të gabuar të ligjit material, kjo për faktin se e paditura drejtë ka zbatuar Nenin 35 të Ligjit

nr.03/L-222 për Administratën Tatimore dhe Procedurat, pasi që ka marr njoftimin nga paditësi të datës 02.12.2016, sipas të cilit personi fizik A.H., pronari i biznesit NT “Viva Pharmacie” për shkak të një gabimi teknik të sistemit ka arritur që përmes “E Banking,” të realizoj bartjen e mjeteve në shumë prej 99,500.00€, në llogari të bashkëshortes në “TEB Bankë”, me datë 05.12.2016, përmes njoftimit për barrë dhe masa për marrje pasuri/urdhri për transfer ka kërkuar që borxhin tatimor të biznesit NT “Viva Pharmacie” në shumë prej 72,913.05€, ta paguan paditësi.

Nga tërë kjo që u cekë më lartë dhe mbi këtë gjendje faktike, kjo gjykatë konsideron se gjendja faktike është vërtetuar drejtë dhe në mënyrë të plotë, ngase nuk është cenuar ligji në dëm të paditësit. Prandaj, pretendimet ankimore në ankesë se gjykata e shkallës së parë gabimisht ka aplikuar edhe të drejtën materiale në dëm të paditësit, ky kolegji nuk i aprovoi, sepse vlerësoi se te njëjtat janë të paqëndrueshme dhe të pa bazuara për tu aprovuar ankesa, dhe se janë të pa ndikim në vërtetimin e një gjendje tjetër faktike nga ajo e vërtetuar edhe nga gjykata e shkallës së parë. Sepse, aktgjykimi i ankimuar i gjykatës së shkallës së parë, është i qartë dhe i kuptueshëm si dhe përmban arsye të mjaftueshme për faktet vendimtare, të cilat i pranon edhe kjo gjykatë, andaj, ankesa, e paditësit u refuzua si e pa bazuar, ndërsa aktgjykimi i ankimuar u vërtetua si i drejtë dhe i ligjshëm. Duke marrë parasysh se gjykata e shkallës së parë, në mënyrë të drejtë ka zbatuar dispozitat procedurale dhe materiale, me rastin e refuzimit të kërkesëpadsisë së paditësit, e pasi që me pretendimet tjera ankimore të përsëritura, të njëpasnjëshme, një aktgjykim i tillë nuk mund të vihet në pyetje, ankesa e paditësit, u refuzua si e pa bazuar, ndërsa aktgjykimi i ankimuar u vërtetua si i drejtë dhe i ligjshëm.

Mbi këtë bazë e në mbështetje të nenit 49 të LKA-së, lidhur me nenin 200 të LPK-së, të aplikueshëm sipas nenit 63 të LKA-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

## GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS

Dhomat e Shkallës së dytë

K.Dh.Sh.II.nr.222/22, me datë 12.11.2024

Kryetar i kolegjit, gjyqtari  
Dren Rogova